



Datë: 14.04.2025

Numër Protokolli: 3082/2025

A.nr.456/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.456/2025, të datës 12.03.2025, të parashtruar nga V.B, kundër organit të punësimit: Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 14.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.456/2025, të datës 12.03.2025, e parashtruar nga ankuesi V.B.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, V.B (*tutje referuar vetëm ankuesi*) me datë 12.03.2025, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos kategorizimit të pagës në kategorinë e eksperteve klasa B6-11.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 17.03.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, ndërsa, kjo e fundit më datë 24.03.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë, se bashku me provat materiale ndërlidhur më çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1615/2024 të datës 12.03.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 20.01.2025 nga H.M për D.H; Emailin e datës 17.01.2025 nga D.H për H.M; Emailin e datës 16.01.2025, 26.12.2024 nga H.M për D.H; Emailin e datës 09.12.2024 nga D.H për ankuesin; Emailin e datës 09.12.2024 nga ankuesi për D.H; Emailin e datës 04.11.2024 nga ankuesi për S.L; Emailin e datës 31.07.2024 nga ankuesi për ASHI; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 17.03.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 24.03.2025; Akt Emërimit e

datës 25.03.2019; Përshkrimin e detyrave të punës Zyrtar i Lartë për Teknologji Informativë i datës 25.03.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e ankuesit është e palejuar, **sepse**:

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit dhe së i njëjti sipas Akt Emërimit me numër protokolli 236 të datës 25.03.2019, mbanë pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Teknologji Informativë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon se Zyrtar më i lartë administrativ i institucionit nuk e ka dërguar pyetësin tek Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike dhe nga kjo është dëmtuar në kategorizim të pagës, pretendon së pozita e tij duhet të kategorizohet si ekspert sipas Rregullores Nr.11/2023 për Ekspertët, gjegjësisht në grupin B6, koeficient 11.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pranueshmërinë e ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3 ku përcaktohet se: *3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 124 ku përcaktohet se: 1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim, dhe si rrjedhojë referuar dispozitave përkatëse ligjore konstatoi se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme të cilat burojnë nga marrëdhënia e punës, mirëpo kur kemi të bëjmë me realizimin e të drejtave sikurse në rrethanat e rastit konkret, nëpunësi civil fillimisht duhet t'i drejtohet organit të punësimit me kërkesë për realizimin e të drejtës së pretenduar, dhe vetëm kundër aktit për refuzimin e kërkesës apo heshtjes së organit publikë në raport me kërkesën e parashtruar, mund të parashtoj ankesë, sipas afateve të përcaktuara me dispozitat e nenit 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Përkundër që ankuesi në ankesë thekson se ka ripërsëritur kërkesën për rregullim të pagës ashtu që pozita e tij të kategorizohet në grupin e pozitave të eksperteve, Kolegji nga analizimi i provave materiale nuk ka gjetur ndonjë dëshmi që provon faktin që ankuesi t' i jetë drejtuar Zyrtarit Kryesor Administrativ të institucionit më një kërkesë të tillë. Andaj, në mungesë të kërkesës së parashtruar të organi i punësimit për realizimin e të drejtës së pretenduar, në rastin konkret nuk kemi objekt trajtimi ngase mungon veprimi apo mosveprim nga organi i punësimit në raport me të drejtën e pretenduar në ankesë, për çka ankuesi mund të kontestonte ligjshmërinë e veprimit të organit të punësimit, apo mosveprimin e tij.

Në kuptim të së drejtës në mbrojtje juridike të të drejtave nga marrëdhënia e punës, si një nga të drejtat themelore të garantuara me kushtetutë dhe ligj, Kolegji rithekson faktin së hedhja poshtë e ankesës A.nr.456/2025, nuk nënkupton vendosjen në mënyrë meritore lidhur me ligjshmërinë e pretendimeve ankimore të ankuesit, pasi që, siç u tha me sipër, ankuesi fillimisht duhet të parashtojë kërkesë pranë

institucionit punëdhënës, e me pastaj mund të ushtrojnë ankesë në Këshill ndaj veprimit(akti administrativ) apo mos veprimit (heshtjes) të organit përkatës, në pajtim me nenin 127 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.456/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit V.B;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;